

MBI AUDITIMIN FINANCIAR TË USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E AVOKATIT TË POPULLIT

Raporti Përfundimtar i ushtruar në Institucionin e Avokatit të Popullit, me objekt “*Auditim Financiar*” për periudhën 01.01.2014 deri më 30.10.2015 si dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH Nr. 165, datë 26.12.2015. Bazuar në nenet 15, 25, 30 dhe 32 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, me shkresën nr. 785, datë 26.12.2015, Raporti Përfundimtar i Auditimit Financiar dhe rekomandimet përkatëse i janë dërguar z. I T, Avokat i Popullit, ku janë rekomanduar dhe kërkuar zbatimi i masave të mëposhtme:

A. OPINIONI I AUDITUESIT

Bazat për opinion të kualifikuar mbi besueshmërinë e pasqyrave financiare

Nga auditimi u konstatua se, Institucioni i Avokatit të Popullit nuk ka Rregjistër të Aktiveve të hartuar në varësi të llojit si edhe grupit përkatës brenda llojit, sipas kërkesave të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Në mungesë të Regjistrit Kontabël të Aktiveve si edhe **në mungesë të evidencave të duhura mbështetur mbi ISSAI 1500¹**, grupi i auditimit nuk mund të japë siguri të arsyeshme sa i takon vlerësimit dhe kontabilizimit të pasurisë së këtij institucioni prej 60,759,707 lekë (reflektuar te Aktivet e Qëndrueshme, kosto historike plus amortizim), **i cili përfaqëson 89% të total Aktivit, duke gjykuar se pasuria e institucionit e shprehur në Aktivin e Bilancit kontabël nuk është e saktë.**

Gjithashtu u konstatua se, pasuria e Institucionit të Avokatit të Popullit është shtuar me një shumë prej 8,618,690 lekë në vitin 2014 (softwarë-ve, kompjuterëve dhe pajisje zyrash) financiar me fondet e grantit danez, në kundërshtim me marrëveshjen me donatorin, neni 9, pika (b) e të cilës përcakton se, pajisjet, materialet, furniturat dhe facilitetet e blera nga Ministria e Jashtme Daneze dhe të përdorura gjatë implementimit të programi mbeten në pronësi të Danimarkës, deri në një moment që palët mund të bien dakord ndryshe). Ndërkohë që të ardhurat që Institucioni ka përfituar nga granti nuk reflektohen në Pasqyrën e te Ardhurave dhe Shpenzimeve, në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë si edhe VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”.

Opinion i kualifikuar.

Në gjykimin e KLSH-së, si edhe mbështetur në ISSAI 1705², përveç efekteve të çështjeve të përshkruara te “*Bazat për opinion të kualifikuar*”, pasqyrat financiare vjetore të Institucionit të Avokatit të Popullit, paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Institucionit të Avokatit të Popullit më datë 31.12.2014 dhe rezultatet e operacioneve dhe flukseve të arkës, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Është në përgjegjësinë tonë, si auditues të pavarur, të shprehemi se, evidencat e auditimit të ofruara për çështjen e aktiveve (format Excel i pashpjegueshëm nga subjekti) janë të pamjaftueshme dhe ofrojnë një bazë të mjaftueshme për dhënien e opinionit të kualifikuar.

¹ ISSAI 1500: Objektivi i audituesit është të hartojë dhe kryejë procedura auditimi, në mënyrë që të sigurojë evidencat të mjaftueshme, relevante dhe të besueshme

² ISSAI 1705: Objektivi i audituesit është të shprehë qartë një opinion të modifikuar mbi pasqyrat financiare, i nevojshëm nëse (...) audituesi e ka të pamundur të sigurojë evidencat e duhura për të konkluduar se, pasqyrat financiare nuk përmbajnë gabime materiale dhe që transaksionet e kryera, përputhen në të gjitha aspektet materiale me ligjet dhe rregullat në fuqi.

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Nga auditimi i zërave të Bilancit Kontabël u konstatua se, Institucioni nuk ka regjistër të aktiveve të hartuar në varësi të llojit si edhe grupit përkatës brenda llojit, sipas kërkesave të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”*. Në mungesë të Regjistrit Kontabël të Aktiveve si edhe në mungesë të evidencave mbështetur mbi ISSAI 1500³, grupi i auditimit nuk mund të japë siguri të arsyeshme sa i takon vlerësimin dhe kontabilizimin të pasurisë (*reflektuar te Aktiv*) së këtij institucioni prej 127,814,172 lekë, duke gjetur se pasuria e institucionit e shprehur në Aktivin e Bilancit kontabël nuk është e saktë.

Nga auditimi i aktiveve gjithashtu u konstatua se, është transferuar pronësia e aseteve (*softwarëve, kompjuterëve dhe pajisje zyrash*) në vlerën 8,618,690 lekë për llogari të Avokatit të Popullit, duke prekur kështu llogarinë e Aktiveve të Qëndrueshme në Bilancin Kontabël, pa miratim nga palët, në kundërshtim me marrëveshjen me donatorin neni 9, pika b e të cilës përcakton se, pajisjet, materialet, furniturat dhe facilitetet e blera nga Ministria e Jashtme Daneze dhe të përdorura gjatë implementimit të programi mbeten në pronësi të Danimarkës, deri në një moment që palët mund të bien dakord ndryshe.

Për këtë rekomandojmë:

Nëpunësi Autorizues i njësisë brenda strukturës së institucionit, të caktojë nëpunësin zbatues për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit. Regjistri i aktiveve të një njësie, duhet të përfshijë si aktivet afatgjata ashtu edhe aktivet afatshkurtra materiale dhe monetare si dhe të specifikojë aktivet të cilat gjenden në pronësi të njësisë dhe ato që gjenden nën administrimin e njësisë. Gjithashtu Institucioni të marrë masa të analizojë dhe saktësojë në mënyrë të detajuar gjithë zërat që përfaqësojnë aktivin e Bilancit e vetëm ata zëra që plotësojnë kriterin e pronësisë, të regjistrohen si Aktiv.

Sa i takon konstatimit të regjistrimit me pa të drejtë të aktiveve në Bilancin Kontabël, Institucioni të marrë masa për nxjerrjen jashtë bilancit të kësaj llogarie, deri sa të saktësohet statusi i këtyre aktiveve nëpërmjet aprovimit nga Qeveria Daneze, në mbështetje të kushteve të kontratës me donatorin.

Brenda datës 31.12.2015

2. Nga auditimi i aktiveve u konstatua se, godina ku aktualisht ushtron aktivitetin Avokati i Popullit nuk është e regjistruar si aset në Bilanc, edhe pse ka një VKM për kalimin në përgjegjësi administrimi të pronës nga MZHETS te Avokati i popullit, që daton që më 21.06.2006. Nga ana e Institucionit nuk është marrë asnjë masë për finalizimin e procesit, ndërkohë që Institucioni pretendon se, te zëri *“Ndërtesa”* ka të regjistruar vetëm shtesat e investimeve kapitale, te kryera mbi këtë godinë, për të cilën Institucioni i Avokatit të Popullit nuk ushtron të drejtën e pronësisë, në kundërshtim me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 *“Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”* dhe me kërkesat e ligjit Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 *“Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”*, i ndryshuar.

Për këtë rekomandojmë:

Institucioni të marrë masa për të finalizuar procesin e kalimit në administrim të godinës ku aktualisht ushtron aktivitetin, me qëllim njohjen e kësaj godine si aktiv në Bilancin kontabël. Vetëm pasi të njihet e drejta e pronësisë mbi pronën, mund të vijohet të reflektohen gjithë shpenzimet kapitale të kryera ndër vite mbi këtë pronë, duke mos shtrembëruar aktivin e bilancit kontabël dhe mos e ngarkuar atë më zëra që ligjërisht nuk mund të regjistrohen si të tillë. Për sa më sipër Institucioni i Avokatit të Popullit, të sigurojë evidenca të mjaftueshme dhe të besueshme sa i takon pronësisë dhe vlerës së tyre.

Brenda 31.12.2015

3. Nga auditimi i pasqyrave financiare u konstatuan parregullsi në përlllogaritjen dhe regjistrimin e zërave kontabël si vijon:

³ ISSAI 1500: Objektivi i audituesit është të hartojë dhe kryejë procedura auditimi, në mënyrë që të sigurojë evidenca të mjaftueshme, relevante dhe të besueshme

- Aktivitet e Patrupsuara janë amortizuar më një normë amortizimi 1%, kundrejt normës së lejuar prej 15%, në kundërshtim me VKM 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, i ndryshuar.

- Në mungesë të regjistrit të aktiveve, nga i cili grupi i punës të mund të sigurojë informacion të saktë dhe të besueshëm sa i takon kostos historike edhe për Aktivitet e Trupsuara, gjykojmë se pavarësisht aplikimit të saktë të normës së amortizimit për këto aktive, nuk japim dot siguri të arsyeshme sa i takon përllogaritjes së total vlerës së këtij zëri.

Për këtë rekomandojmë:

Institucioni të marrë masa të saktësojë - mbështetur në dokumentacion të saktë, i cili gjithashtu të shërbejë si evidencë e mjaftueshme, relevante dhe e besueshme, për regjistrimin e këtij zëri si Aktiv i Patrupsuar ose jo - se çfarë përfaqësojnë Aktivitet e Patrupsuara e në varësi të kësaj të aplikojë normat e duhura të amortizimit në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe për sa më sipër të bëhen sistemimet kontabël.

Brenda 31.12.2015

4. Nga auditimi, u konstatua se, gjatë vitit 2014 dhe periudhës Janar-Shtator 2015, Institucioni Institucioni i Avokatit të Popullit ka vepruar me struktura jo të plota dhe vazhdimisht të ndryshueshme, mesatarisht me 6 punonjës më pak për vitin 2014 dhe 7 punonjës më pak për vitin 2015, të cilët përfshijnë edhe pozicione të nivelit drejtues, duke e ekspozuar entitetin përpara riskut të mos kryerjes me efikasitet të funksioneve të paracaktuara me ligj.

Për këtë rekomandojmë:

Institucioni të bashkëpunojë për të plotësuar sa më shpejt pozicionet e lira, pavarësisht problemeve të njohura, kjo me objektivin për të funksionuar si një institucion i kompletuar nga pikëpamja e vendim-marrjes dhe asaj operacionale, të cilat sigurojnë efektshmëri të realizimit të funksioneve të vetë institucionit. Në çdo rast, buxheti i programuar duhet të reflektojë strukturën faktike të institucionit, duke u larguar nga praktika e verifikuar deri tani, ku buxheti i programuar nuk reflekton treguesit faktike të kostove të lidhura me personelin.

Menjëherë dhe në vazhdim

5. Nga auditimi i krijimit dhe përdorimit të fondeve buxhetore u konstatua se, Institucioni, nuk ka raportuar për 3-mujorin e dytë të vitit 2014 në Ministrinë e Financave, në kundërshtim me kërkesat e ligjit “Për Buxhetin e Vitit 2014”, si edhe ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Nga auditimi i krijimit dhe përdorimit të të ardhurave të tjera (grantit) u konstatua se, aktualisht Institucioni i Avokatit të Popullit, në kuadër të raportimeve periodike për grantin danez nuk ka kryer raportime në Drejtorinë e Thesarit dhe Borxhit në Ministrinë e Financave, për të ardhurat dhe shpenzimet progresive për muajin paraardhës në muajin shkurt dhe maj të vitit 2014; - ka tejkaluar afati i raportimit për muajit mars 2015, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 17.02.2003; dhe

- Që prej vitit 2013 kur është disbursuar transhi i parë i grantit, Avokati i Popullit nuk ka dorëzuar kopje të regjistrit me hyrjet dhe daljet në Kontrollin e Lartë të Shtetit dhe një kopje në Komisionin e Përhershëm të Ekonomisë, çdo fund viti ushtrimor, në kundërshtim me nenin 37, të ligjit 155/2014 “Për Avokatin e Popullit”, deri në Korrik të vitit 2015, kur edhe është raportuar për herë të parë në këto dy Institucione.

Për këtë rekomandojmë:

Institucioni të marrë masa që në të ardhmen (edhe për financime të tjera në rastet që do të ketë), të raportojë periodikisht sipas afateve të parashikuara, duke mos penguar procesin parimet e transparencës edhe të respektimit me rreptësi të tërësisë së procesit për funksionimin e sistemit buxhetor.

Vazhdimisht

6. Nga auditimi u konstatua se, të ardhurat që Institucioni ka përfituar nga grantet nuk reflektohen në Pasqyrën e të Ardhurave dhe Shpenzimeve, në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë si edhe VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”. Mos reflektimi i donacioneve në pasqyrat financiare të total vlerës së disbursuar (deri në Shtator

2015, konstatuar vlere prej 50,467,223 lekë), përjashton efektet financiare të këtij donacioni, në Rezultatit Ushtrimor dhe te Aktivitet të Institucionit.

Për këtë rekomandojmë:

Institucioni i Avokatit të Popullit të marrë masa të menjëhershme të reflektojë të ardhurat e përfituara nga grantet dhe të gjitha flukset dalëse që lidhen me këtë fond, në pasqyrat financiare të Institucionit, me qëllim menaxhimit me efektivitet dhe transparencë të fondeve publike, në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit publik.

Brenda datës 31.12.2015

7. Institucioni i Avokatit të Popullit, për auditimin e projektit danez, ka kontraktuar tre auditues të jashtëm, në vitin 2014, dhe një auditues në vitin 2015. Përzgjedhja e fituesit në vitin 2014, është bërë me procedura tenderi të përqendruar nga Ministria e Punëve të Brendshme, me kërkesë të Avokatit të Popullit, ndërkohë që fondi limit është përcaktuar nga institucioni, por *për të cilën nuk ka asnjë gjurmë që formalizon përcaktimin e fondit limit dhe nuk është ngritur asnjë grup pune “Për përllogaritjen e Fondit Limit dhe Specifikimeve Teknike”, duke shkelur parimin e transparencës edhe parimin e respektimit me rreptësi të tërësisë së procesit për funksionimin e sistemit buxhetor*, mbështetur në nenin 4 të ligjit nr. 9963, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, si edhe në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, si edhe Urdhrit nr. 33, datë 11.07.2013, “Për gjurmët standarte të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”.

Auditimi nga ekspertë të jashtëm në vitin 2014 ka kushtuar 1,176,960 lekë dhe për vitin 2015, 288,000 lekë, diferenca e lartë në vlerën e kontraktimit të këtij shërbimi në dy vitet e fundit, nxjerrin në pah difektet e llogaritjes së fondit limit, i cili nëse do të referoheshim tarifave të shërbimit të njohura nga IEKA, shpallur në vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të saj, bazuar në vlerën e fondeve të disbursuara duhej të ishte rreth 120,000 lekë. Në këto kushte gjykojmë se institucioni kishte mundësi që shumën ta përdorte më me efikasitet në arritjen e objektivave kryesorë të institucionit dhe jo si kosto mbështetëse.

Për këtë rekomandojmë:

Institucioni i Avokatit të Popullit të marrë masa që shpenzimi i grandit të bëhet me kujdes duke synuar përmbushjen e qëllimeve dhe objektivave publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përbashatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si edhe përdorimit të fondeve publike, me ekonomikitet, efektivitet dhe efikasitet. Kontraktimi i shpenzimit të auditimit në vijim, të bazohet në një fond limit të përcaktuar mbi tarifat e shërbimit publik të miratuara nga IEKA

Menjëherë dhe në vazhdim

8. Nga auditimi u konstatuan 2 raste për ekzekutim të vendimeve gjyqësore, *për ndërprerje të marrëdhënieve të punës pa shkaqe të arsyeshme*, për 2 punonjës të nivelit drejtues, e konkretisht 1 Drejtues Njësie dhe 1 Këshilltar i Avokatit të Popullit, për të cilët institucioni detyrohet që të paguajë për ekzekutimin e këtyre vendimeve një shumë totale prej 4,833,643 lekë. Kjo shumë është planifikuar të paguhet në dy transhe: transhi i parë në vitin 2015 prej 3,000,000 lekë dhe transhi i dytë prej 1,833,643 lekë, në vitin 2016. Deri pa u ekzekutuar shuma prej 4,833,643 lekë, përbën menaxhim jo efektiv të fondeve e që në momentin e ekzekutimit do të shndërrohet përdorim joefektiv fondesh.

Për këtë rekomandojmë:

Për përmirësimin e punës dhe rritjen e përdorimit efektiv të fondeve buxhetore, Institucioni i Avokatit të Popullit, në të ardhmen të mos marrë veprime për ndërprerjen e marrëdhënieve financiare të punonjësve me institucionin, të pa argumentuara dhe të pa mbështetura në dispozitat ligjore përkatëse në fuqi.

Vazhdimisht

9. Nga auditimi zonave të llogarisë u konstatua se, institucioni nuk ka vendosur kritere bazë dhe procedura standarde të miratuara për ndryshimin e nivelit të pagës për ndihmës-komisionerët nga kategoria II-a në II-b, duke mos reflektuar transparencë në ndryshimin e kategorive mes punonjësve që faktikisht kryejnë të njëjtat funksione.

Për këtë rekomandojmë:

Institucioni i Avokatit të Popullit, të marrë masa për miratimin e kriterëve dhe procedurave që duhen ndjekur për ndryshimin e nivelit të pagës për ndihmës-komisionerët nga kategoria II-a në II-b, me qëllim rritjen e transparencës dhe argumenteve të drejtë sa i takon ndryshimeve të kategorive mes punonjësve që faktikisht kryejnë të njëjtat funksione.

Menjëherë

10. Nga auditimi i ligjshmërisë dhe saktësisë së veprimeve të kryera me arkën në valutë është konstatuar se për vitin 2014 në 20 praktika dhe për vitin 2015 në 10 praktika nuk është respektuar siç sistemi i firmës së dyfishtë, mungon nënshkrimi i nëpunësit urdhërues, si dhe nuk ka nënshkruar nëpunësi zbatues i institucionit, por përgjegjësi i sektorit të financës dhe administratës në kundërshtim kjo me udhëzimin nr. 2, datë 06.02.2012, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, si dhe ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, si dhe udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Nga auditimi është konstatuar se, e njëjta mangësi ekziston edhe në mandatpagesat dhe mandatarkëtimet (si për vitin 2014 ashtu edhe për vitin 2015) të cilat nuk janë të pajisura me të gjitha firmat përkatëse. Konkretisht mandatarkëtimet kanë vetëm nënshkrimin e financierit (përgjegjësit të sektorit të financës dhe administratës), por nuk kanë nënshkrimin e arkëtarit. Po kështu, mandatpagesat kanë nënshkrimin e financierit dhe të marrësit, por mungon nënshkrimi i drejtorit dhe arkëtarit.

Për këtë rekomandojmë

Në të gjitha praktikatat e veprimeve të kryera me arkën, të respektohet parimi i firmës së dyfishtë, nënshkrimi i nëpunësit urdhërues dhe nëpunësit zbatues i institucionit. Për mandatpagesat dhe mandatarkëtimet të respektohen të gjitha shkallët e firmosjes së dokumentit për ta bërë atë të vlefshëm dhe të rregullt.

Menjëherë

11. Nga auditimi është konstatuar se me urdhrin e shpenzimeve nr. 120 për blerje karburanti është likuiduar fatura nr. 07, datë 03.06.2014 me nr. serie 14807407 në vlerën totale prej 893,010 lekë. Bashkëlidhur urdhrin të shpenzimeve gjenden fletë hyrjet në magazine shoqëruar me procesverbalin përkatës, ku specifikohet se është kryer verifikimi i përputhjes sasiore dhe çmimeve sipas kontratës, faturës shoqëruese dhe gjendjen fizike, si dhe është kryer verifikimi i përputhjes së emërtesave, llojeve dhe karakteristikave teknike sipas kërkesave të kontratës dhe në dokumentet shoqëruese të mallit me gjendjen fizike, por nga auditimi konstatohet se praktika nuk është e shoqëruar me deklaratën doganore SAD dhe me Raportin e Analizimit para Zhdoganimit i cili kryet nga Inspektorati Qendror Teknik si prove për verifikimin e cilësisë dhe karakteristikave të karburantit të dorëzuar.

Është konstatuar gjithashtu se në përllogaritjen e çmimit nga ana e operatorit ekonomik “K..” sh.a është përfshirë si pjesë e tij edhe markimi i karburantit ($0.614 \text{ lekë për litër pra për gaoilin është paguar më tepër } 3000 \text{ litra} \times 0.614 = 1842$, ndërsa për benzinën $2000 \text{ litra} \times 0.614 = 1228$), i cili nuk parashikohet si taksë kombëtare nga ligji nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar.

Për këtë rekomandojmë:

Institucioni të marrë masa që për praktika të ngjashme në të ardhmen të kryejë verifikimin e dokumenteve bashkëlidhur nga operatori ekonomik me qëllim verifikimin e përputhjes sasiore dhe çmimeve sipas kontratës, faturës shoqëruese dhe gjendjen fizike, si dhe verifikimin e përputhjes së emërtesave, llojeve dhe karakteristikave teknike, konkretisht Raportin e Analizimit para Zhdoganimit dhe deklarata doganore SAD.

Sa i takon përllogaritjes së markimit të karburantit, Institucioni të marrë masa për të verifikuar në të ardhmen që kjo tarifë të mos përfshihet nga operatori ekonomik si taksë kombëtare, e cila i shtohet çmimit të karburantit

Menjëherë dhe vazhdimisht

12. Nga auditimi rezulton se me Urdhrin e Brendshëm nr. 228, datë 26.11.2014 “Për Ngritjen e Komisionit të Inventarizimit Fizik të Aktiveve të Institucionit të Avokatit të Popullit”, është ngritur Komisioni i Inventarizimit të Aktiveve afatgjata dhe afatshkurtra të institucionit. Nga auditimi i dosjes së inventarizimit të dorëzuar pranë grupit të auditimit nuk mund të verifikojmë datën e dorëzimit të këtij inventari, pasi komisioni i inventarizimit nuk e ka dorëzuar atë të

shoqëruar me procesverbalin dhe raportin përkatës, në kundërshtim me Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”; është konstatuar se komisioni i inventarizimit në kundërshtim me pikën 3 të urdhrit nr. 228, datë 26.11.2014 nuk ka pasqyruar në procesverbalin përkatës të dhënat e inventarizimit, si dhe për arsye të mungesës së tij nuk janë të pasqyruara gjendja e rezultuar nga verifikimi fizik dhe cilësor i aktiveve në ngarkim/përdorim të punonjësve të institucionit; është konstatuar se komisioni, në kundërshtim me urdhrit nr. 228, datë 26.11.2014 nuk ka përpiluar një raport në lidhje me inventarizimin fizik të aktiveve, kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave dhe dëmtimeve të konstatuar, për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës. Po kështu është konstatuar se për shkak të mungesës së raportit të sipërcituar dhe procesverbalit përkatës nuk mund të verifikohet nëse i gjithë dokumentacioni i inventarizimit i është dorëzuar Sekretarit të Përgjithshëm Brenda 10 ditëve nga përfundimi i inventarizimit.

Për këtë rekomandojmë:

Institucioni të kryej procedurat e inventarizimit çdo fund viti si dhe të ngrejë procedurat e nevojshme me qëllim kryerjen e inventarizimit fizik të aktiveve, me anë të së cilit të verifikohen kushtet e ruajtjes së tyre, gjendja fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave dhe dëmtimeve të konstatuar, shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës, me qëllim menaxhimin me efektivitete të aktiveve të Institucionit si edhe verifikimin e afateve të dorëzimit të inventarëve.

Vazhdimisht

13. Nga auditimi është konstatuar se me urdhër nr. 80, datë 16.04.2011 është ngritur Grupi për Menaxhimin Strategjik dhe është caktuar në cilësinë e koordinatorit të riskut, Sekretari i Përgjithshëm, kur institucioni nuk ka miratuar një strategji risku. Grupi i Menaxhimit Strategjik zhvillon mbledhje të rregullta periodike sipas përcaktimeve të nenit 27 të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, por këto takime nuk janë të dokumentuara. Nga auditimi është konstatuar se në kundërshtim me nenin 15 të ligjit 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, nuk ekzistojnë rregulla ose procedura të brendshme të cilat të trajtojnë delegimin e të drejtave dhe detyrave. Konstatohet se në praktikë nuk funksionon delegimi i detyrave dhe se nuk ka procedura delegimi të dokumentuara. Nga auditimi është konstatuar se punonjësit mbikëqyren nga eprorët e tyre për kryerjen e detyrave apo nga drejtuesit e linjës, por konstatohet se ka raste kur mbikëqyrja është formale.

Për këtë rekomandojmë:

Grupi i Menaxhimit Strategjik të marrë masat e duhura për të hartuar strategjinë e riskut të institucionit me qëllim identifikimin e zonave me risk në procedurat e sistemit të kontrollit të brendshëm. GMS të dokumentojë mbledhjet e takimeve të kryera me qëllim diskutimin e çështjeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Menjëherë dhe vazhdimisht

14. Me shkresë të Ministrisë së Financave nr. 18220, datë 16.12.2013 është konfirmuar si Nëpunës Zbatues për Institucionin e Avokatit të Popullit dhe për Projektin Danez, zj. M. S., me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve dhe arsim juridik, por që konkretisht nuk ushtron detyrat që rrjedhin nga kjo përgjegjësi. Me autorizime të herëpashershme të Sekretarit të Përgjithshëm, z. F. Z., detyrat e nëpunësit zbatues i caktohen z. I. L, me detyrë Përgjegjës Sektori i Financës. Në këtë institucion zbatohet formalisht kërkesa e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin për vartësi direkt të nëpunësit zbatues me nëpunësin autorizues, por praktikisht veprohet në kundërshtim me ligjin. Nga auditimi konstatohet se në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar në institucionin e Avokatit të Popullit nëpunësi zbatues ka arsim të lartë juridik, ndërkohë që duhet të ketë arsim të lartë ekonomik.

Për këtë rekomandojmë:

Institucioni të marrë masa që të caktojë në rolin e nëpunësit zbatues të institucionit personin me arsimin e kërkuar nga ligji për menaxhimin financiar dhe kontrollin, duke respektuar në të njëjtën kohë vartësinë direkt të nëpunësit zbatues nga nëpunësi autorizues. Gjithashtu institucioni të përcaktojë qartë, për të ardhmen, procedurat e nevojshme për delegimin e detyrave të nëpunësit zbatues, si dhe procedurat për mbikëqyrjen e punës së sektorit të financës.

Menjëherë

15. Nga auditimi u konstatua se, për dosjet - objekt prokurimi pas Qershorit 2014, mungon urdhri i Autoritetit Kontraktor, në të cilin ngarkohet dhe kërkohet përgatitja e kërkesave për përgatitjen e Regjistrimit të Prokurimeve Publike (RRPPP), sipas kërkesave të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 dhe Urdhrit nr. 57, datë 12.06.2015, ku te “*Lista e Proceseve të Punës Për Prokurimet me Vlerë më të Vogël < 400 000 lekë pa TVSH*”, si hap i I-rë është pikërisht ky proces.

Për këtë rekomandojmë:

Institucioni të marrë masa që në fillim të nisjes së procedurës së prokurimit për blerje me vlerë të vogël, të caktojë personin e autorizuar për miratimin e urdhrit nga ku të kërkohet përgatitja e kërkesave për përgatitjen e Regjistrimit të Parashikimeve të Prokurimeve Publike.

Menjëherë

16. Nga auditimi në fushën e prokurimeve u konstatua se, në të gjitha dosjet e prokurimeve mungon Urdhri i Titullarit për ngritjen e grupit të punës për të bërë testimin e tregut dhe përlllogaritja e fondit limit: si për prokurimet me vlerë të vogël dhe të madhe, të kryera përpara Qershorit 2014 në kundërshtim me UMF nr. 33, dt.11.07.2013 “*Gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë*”; ashtu edhe për prokurimet me vlerë të lartë, pas Qershorit 2014 e në vijim, në kundërshtim me UMF nr. 57, datë 12.06.2014 “*Për gjurmët standarde të auditimit*”. Edhe në rastet kur ky testim është kryer mbi bazë të çmimeve të tregut, konstatohet se por nga punonjës të pa autorizuar nga Titullari, në kundërshtim me udhëzimet e sipërpërmendura si edhe kërkesat e Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*”, i ndryshuar.

Njësia e prokurimit në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “*Rregullat për Prokurimin Publik*” si edhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, në të gjitha rastet ka parashtruar specifikimin sa i takon dëshmisë së ofertuesve potencial të shërbimeve të mëparshme, të ngjashme, por pa specifikuar afatin kohor të kërkuar (brenda 3 viteve).

Për këtë rekomandojmë:

Titullari i Autoritetit Kontraktor apo personi i autorizuar prej tij të marrë masa për miratimin e urdhrit ku të kërkohet jo vetëm ngritjen e grupit të punës për përlllogaritjen e fondit limit për tenderat me vlerë të lartë, por edhe të përcaktohet metodologjia e përdorur për të bërë testimin e tregut.

Njësia e prokurimit në çdo rast në vazhdim, të theksojë afatin kohor të kërkuar për t’u përmbushur nga OE-të pjesëmarrës si pjesë e dokumentacionit, të vlefshëm për procedurat e prokurimit, në Dokumentet Standarde të Tenderit.

Menjëherë dhe vazhdimisht

17. Në tenderin e zhvilluar në platformën elektronike me objekt “*Organizim Eventesh (konferenca, trajnime, seminare)*”, me nr. referencë 44408 datë 30.06.2014 u konstatua se:

a. [REDAKTUAR] sh.p.k. nuk ka dorëzuar asnjë kontratë të ngjashme dhe asnjë vërtetim nga porositiçi për realizim të kënaqshëm të kontratës, në kundërshtim me DST, kërkesat për kualifikim ku, te kapaciteti teknik citohet: “*.....Për të provuar realizimin e kontratave duhet të paraqesë kontratën, faturën tatimore dhe vërtetim nga porositiçi për realizim të kënaqshëm të kontratës*”; gjithashtu operatori nuk ka përmbushur kapacitetet teknike në kundërshtim edhe të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 germën “ç” të pikës 4; dhe

b. bazuar në ekstraktin e QKR-së, një ndër operatorët pjesëmarrës, C&P shpk, nuk ka si objekt veprimtarie “*organizim eventesh*”, në kundërshtim me kërkesat për kapacitet ligjor të operatorëve ekonomikë. Gjithashtu u konstatua se për këtë operator nuk rezulton të jetë dorëzuar shtojca ekstra “*Deklarata e Gjendjes Gjyqësore*” e kërkuar në DST, mungesa e të cilit duhet të çojë në s’kualifikim të operatorëve. Edhe pse në rastin në fjalë, ka fituar operatori me ofertën më të ulët, mosndjekja me rigoroze të specifikimeve ligjore të sipërpërmendura lë vend për shkelje në të ardhmen.

Për këtë rekomandojmë:

Nisur nga konstatimi i mësipërm, autoritetit kontraktor të marrë masa që, në vijim KVO të respektojë procedurat e unfikuara të prokurimeve sa i takon identifikimit dhe vlerësimit të kapacitetit teknik të operatorëve pjesëmarrës, si edhe llojit të aktivitetet të reflektuar në ekstrakte

e tyre, me qëllim kualifikimin në përputhje me kërkesat ligjore, duke rritur njëherazi objektivitetin, transparencën dhe efektivitetin e procesit.

Menjëherë dhe vazhdimisht

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Nga auditimi i zonave të llogarisë, u konstatua se, punonjësi A. B. ka përfituar shtesa për kualifikime pasuniversitare, në kundërshtim me VKM nr. 545, datë 11.08.2011 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë (...)”, të ndryshuar si edhe Udhëzimin nr. 1, datë 16.03.2012 “Për zbatimin e vendimit nr. 545, datë 11.08.2011 (...)”, duke shkaktuar dëm ekonomik në buxhetin e shtetit në masën **240,000** lekë, për vitin 2014, pasi posedon një diplomë studimesh post-master në Universitetin e Evropës Juglindore, në Hungari, shtet që nuk përfshihet në listën e vendeve, për të cilat nëpunësve civilë/nëpunësve dhe funksionarëve u njihet e drejta e shpërblimit për studimet “post-master” sipas Udhëzimit nr. 1 datë 16.03.2012.

Për këtë rekomandojmë:

Institucioni të kërkojë miratim nga Ministria e Arsimit dhe Ministria e Financës, sa i takon përfshirjes së diplomës së z. A. B., sikundër pretendohet, në listën e vendeve për të cilat nëpunësve u njihet e drejta e shpërblimit për studimet “post-master” sipas Aneksit 1, bashkëngjitur Udhëzimit nr. 1, datë 16.09.2012, në të kundërt të merren masa për arkëtimin e shumës prej 240,000 lekë si dëm ekonomik i shkaktuar në buxhetin e shtetit.

Menjëherë

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit: A J, përgjegjëse grupi, H K dhe Xh Ç, më tej materiali u shqyrtua nga Kryeaudituesi, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Zbatimit të Standardeve, Drejtori i Departamentit dhe Drejtori i Përgjithshëm

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT